

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
STUDIMET PASUNIVERSITARE – MASTER
DREJTIMI – KOHA E RE



REZYME E TEMËS SË MASTERIT

me titull:

ZHVILLIMI I ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË 2006 – 2012

Kandidati:

Alban Mazreku

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

Qershor, 2023

Punimi trajton të dhënat kryesore të ndryshimeve të bëra në sistemin arsimor në periudhën 2006 – 2012. Punimi i Masterit në mes tjerash trajtojn me kujdes ecurinë e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë një ngjarje aktuale. Në mes tjerash trajtojmë kryesisht arsimin e lartë në Kosovë në periudhën prej vitit 2006 – 2012. Të arriturat dhe ngecjet që u bënë gjatë kësaj periudhe rreth arsimit në Republikën e Kosovës, si dhe për reformat që u arriten në këtë institucion, Andaj punimin ka këtë strukturë e cila është e përbërë nga gjashtë kapituj dhe disa nentituj. Kapitulli i parë është i përbërë nga kronologjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë, mënyrën se si u zhvillua Arsimi i Lartë në gjuhën shqipe në Kosovë, politikat e programeve të studimeve. Procesi i Bolonjës zë një vend të redësishëm në arsimin e lartë në Kosovë në kapitullin e dytë të temës në mes tjerash është i elaboruar në terësi. Sistem i cili vuri një standard të ri në arsimin e lartë, cilësia e arsimit, si dhe për marrëdhëniet dhe marrveshjet më ndërkombëtarët përreth arsimit. Kapitullin e tretë ka për trajtim politikat e zbatimit të reformave të procesit të Bolonjës dhe zbatimi i ligjitë për avancimin e këtij procesi. nevojën e arritjes së standarteve efikase në zhvillimin e arsimit, qellimin e arritjes se reformave në universitet, si dhe për synimin e Kosovës për tu integruar në hapsirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Sistemi i arsimit, konceptimi dhe sendërtimi i tij, është një çështje sa e rëndësishme, aq edhe e ndërlikuar, sepse varet nga determinante dhe variabla të ndryshme. E tillë është edhe çështja e sendërtimit të sistemit të ri të arsimit në Kosovë.

Në një botë ku sfidat dhe problemet janë miqtë tanë, ku vetë jeta është ndryshim dhe “udhëtim në një destinacion të panjohur”, ku njeriu për të mbijetuar duhet të rinovohet vazhdimisht gjithnjë e me shumë po aktivizohet vlera e pazëvendësueshme dhe ekzistenciale e arsimit. Prandaj, sistemi arsimor sot është një nga sfidat kryesore të secilit vend, asociacioneve dhe të institucioneve relevante ndërkombëtare dhe të njerëzimit në përgjithësiht

Shqiptarët në Kosovë u përballën me persekutime të llojeve të ndryshme, historia e popullit shqiptar dhe historia e arsimit në gjuhën shqipe është e përbashkët. Karshi të gjitha përpjekjeve të parreshtura të patriotëve tanë në luftën për çlirim e bashkim kombëtar e pandashme në një rënë dhe në anën tjetër ishin pushtimet e ndryshme të cilat e pamundësuan herë herë të të menduarit dhe zhvillimin e aktiviteteve arsmiore në Kosovë. Dëshmitë programore dhe dokumentet strategjike e ligjore të këtij studimi do të jenë të dobishmen për historinë e arsimit shqiptar dhe të dhënat e perzantuar do të prekin ndërgjegjën e rrugës së arsimit shqip, tekstit shqip dhe

mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe për hapat e rëndësishëm drejt reformimit dhe integritit të arsimit të lartë në hapsirat evropiane.

Gjatë gjithë periudhës që kemi objekt trajtimi, hetohet përpjekja më serioze për ngritjen e një sistemi arsimor kombëtar është ajo e viteve 1990-1999, padyshim paraqet një prej vendimeve më të rëndësishme dhe më të guximshme të elitës intelektuale e akademike kosovare, ndërsa periudha e viteve 1999-2012, bëri një hap si për shtrirje të arsimit të lartë edhe për një proces të reformës arsimore në të gjitha nivelet e arsimit shqiptar krahasueshëm me arsimin e evropian. Trajtimi i temës në mes tjerash synim kishte ndriçimin e hartimit të politikave shtetërore për arsimin e lartë gjatë viteve 2006 – 2012, avansimit të kuadrit arsimor, rrjetit universitar, planeve dhe programeve mësimore, metodikës së përdorur në mësimdhëniene dhe në analizën e teksteve universitare, si dhe dispozitave ligjore, menaxhimit të arsimit të lartë, menaxhimit financiar. Në këtë punim është shfletuar bibliografi e gjerë të dokumenteve dhe literaturës relevante, plane e programe mësimore, dokumente arkivore të administratave arsimore, gazeta e revista pedagogjike periodike, monografi të shumëta, si dhe botime të veçanta. Ky punim synim ka përpjekjen që sadopak të plotësoi boshllëkun e trajtimit kronologjik e të sintetizuar të kësaj problematike, duke mos harruar asnjëherë plejada të tëra atdhetarësh që ishin në shërbim të zhvillimit e reformës arsimore, një falenderim atdhetar e pedagogjik që ua kushtoj të gjithë atyre që patën guximin dhe urtësinë, dhe e nisën udhën e mundimshme të përhapjes së dritës prometiane të shkrimit të gjuhës shqipe, për të nxjerrë këtë komb nga errësira, duke e rreshtuar në rrjedhat e qytetërimit evropian.

Në këtë periudhë ka ndodhur edhe një evolucion i zhvillimeve të sistemit të arsimit të lartë me trende evropiane të kohës. Jo vetëm kaq, por vlerësoj se ka pasur një lloj “revolucion” të ndryshimeve politikave edukative- arsimore, dokumenteve strategjike sistimore, të infrastrukturës universitare, ligjore, të teksteve shkencore universitare dhe të ndryshimit korrikularë. Prandaj, me trajtimin historik të arsimit në këtë periudhë, sidomos për shkak të një zhvillimi të vrullshëm dhe të tejskajshëm me orientimin evropian në Kosovë janë marrë pak, për të mos thënë fare studiuesit e historisë së arsimit. Burimet historike të shfrytëzuara për këtë punim, janë të larmishme.

Përshkrimi i metodologjisë së hulumtimit dhe objekti i studimit ishte Analiza e mirëfilltë e reformave të sistemit arsimor në Kosovë nga viti 2006 – 2012.